



MAX TV
Selami DURMISHI
Pronar
Skenderaj

Rasti Nr. 2018/3
Ref:1807/801/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2018/3 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për MAX TV ("Pala Përgjegjëse")

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01, e cila ka hyrë në fuqi më 28 korrik 2016. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
2. KPM me datën 17 janar 2018, ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse, që të deponojë në KPM katalogun e kanaleve, si dhe marrëveshjet e reja eventuale për të drejtat e ritransmetimit.
3. KPM nuk ka pranuar përgjigje nga Pala Përgjegjëse në lidhje me kërkesën e KPM-së, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 19 paragrafi 3 të Rregullores KPM-2016/01.
4. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 16 shkurt 2018, i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01, duke e sjell menjëherë katalogun e kanaleve si pjesë të platformës. Poashtu, në Njoftim paralajmërohet që dështimi për të vepruar në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01 edhe pas Njoftimit për Shkelje, do t'i rekomandojë Komisionit të KPM-së të ndërmerri masa ligjore në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së ndaj Palës Përgjegjëse.
5. KPM me datë 16 shkurt 2018, ka pranuar një ankesë nga ana e operatorit të shpërndarjes IPKO ndaj Palës Përgjegjëse, me pretendimin se Pala Përgjegjëse është duke e ritransmetuar kanalën TOP CHANNEL pa të drejtë autoriale.

6. KPM më datë 20 shkurt 2018, ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse që të ofrojë sqarim si dhe të sjell marrëveshjen valide për ritransmetimin e kanalit TOP CHANNEL. Po të njëjtën datë Pala Përgjegjëse ka kthyer përgjigje duke sqaruar se kanalën TOP CHANNEL nuk e ritransmeton fare.
7. KPM me qëllim të vlerësimit të pretendimeve ankimore ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse. Bazuar në raportin e monitorimit të datës 16 prill 2018, KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse është duke ritransmetuar kanalet KLAN TV, ARTA NEWS HD, AL JASSERA BALKSANS dhe TOP NEWS, ndërsa kanali TOP Channel nuk është gjetur në ritransmetim.

Analiza Ligjore

8. Komisioni i KPM-së bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 4 paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.

Neni 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

"I licencuari obligohet të bëjë shpërndarjen e ofruesve të shërbimit mediale bazuar vetëm në marrëveshje valide për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale".

9. KPM, duke u bazuar në Raportin e monitorimit gjen se Pala Përgjegjëse ka në transmetim kanale për të cilat nuk posedon marrëveshje për të drejtat e transmetimit duke dështuar kështu që të marrë hapa të nevojshëm për të ardhur në pajtueshmëri me nenin 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.
10. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura vlerëson se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.

Vendim

11. Komisioni i KPM-së bazuar në nenin 5, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01, urdhëron Palën Përgjegjëse të ndërpresë menjëherë transmetimin e kanaleve KLAN TV, ARTA NEWS HD, AL JASSERA BALKSANS dhe TOP NEWS.
12. Komisioni i KPM-së në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, merr vendim që Pala Përgjegjëse të sanksionohet me gjobë në vlerë prej dy (3,000) mijë euro për shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.
13. Në rast se Pala Përgjegjëse edhe pas pranimit të këtij vendimi nuk i heq kanalet KLAN TV, ARTA NEWS HD, AL JASSERA BALKSANS dhe TOP NEWS nga platforma e shpërndarjes ashtu siç përcaktohet me nenin 5, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01, Komisioni do të ndërmarrë masa tjera sanksionuese ndaj Palës Përgjegjëse, në pajtueshmëri me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

E drejta për Ankesë

14. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
15. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Muja FERATI
Kryetar



10.07.2019

Datë